

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Identifikohen tri viktimat nga varrezat në Zubin-Potok, Kurti: I përkasin “Grupit të Intelktualëve” - Eurone ws Albania
ADRESA	https://euronews.al/kurti-raportet-e-adn-se-per-varrezat-masive-ne-veri-lidhen-me-grupin-e-intelektualeve/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 12:33:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 12:30:35 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	25f9fd8225c39a613f33671a3a76b290c9af08605a8143f65b55c8ade92bcec7
TEKSTI	37ef9de59e3b78de9faa33779475169562dcd5e11cd23a3f1fe9699b995927ca
PAMJA	19e1c7998f56c51fbcc51830be2fa5c86b5f3d98f6eea2402c89dc6ec7f2575b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	31e3a98c493ac0393f3cdcec3cac2a5c1d533256fa9e570d7767f2e3b64e1b0c
E MËPARSHMJA	534f59c8d91bc6857c28514b8d1ef44584d2896bd1389bab3548c7409d162d98
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/31e3a98c493ac0393f3cdcec3cac2a5c1d533256fa9e570d7767f2e3b64e1b0c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK SHBA Lufta në Iran Krim në familje Lufta në Ukrainë

KOSOVË | LAJM KRYESOR

Identifikohen tri viktima nga varrezat në Zubin-Potok, Kurti: I perkasin “Grupit të Intelktualëve”

19 Shtator 2026 | 14:30

Kreu i Qeverisë së Kosovës, Albin Kurti, i cili po qëndron për një vizitë në SHBA në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ka njoftuar se tashmë kanë dalë rezultatet e para të ADN-së për mbetjet mortore të zhvarrosura në Klludër dhe Jabukë të Zubin Potokut.

Kurti thotë se analizat e ADN-së vërtetojnë lidhjen me personat e grupit të njohur si “Grupi i Intelktualëve”, qytetarë të Skenderajt dhe Mitrovica të rrëmbyer dhe zhdukur më 19 prill 1999 nga forcat serbe.

Për tri viktimat e identifikuara, Kurti tregon se janë njoftuar familjarët, të cilët marrin përgjigje pas 27 vitesh

Njoftimi i plotë i Albin Kurtit:

Në nisje të vizitës sime në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, u njoftova nga Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur se janë pranuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur tri raportet e para të ADN-së, nga mostrat e mbetjeve mortore të zhvarrosura në lokacionet e varreve masive në Kalludër dhe Jabukë të Zubin Potokut.

Në më pak se dy muaj nga konfirmimi i varrit të parë masiv, analizat e ADN-së kanë konfirmuar identitetin e tri viktimave, duke vërtetuar lidhjen me personat e grupit të njohur si “Grupi i Intelktualëve”, kryesisht qytetarë nga Skenderaj dhe Mitrovica, të rrëmbyer dhe të zhdukur me dhunë më 19 prill 1999 nga forcat serbe.

Raportet e ADN-së janë ndarë me Institutin për Mjekësi Ligjore dhe mjnjëherë, sot, përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe të Institutit kanë njoftuar familjet e tri viktimave të identifikuara.

Në ditët dhe javët në vijim, presim të pranojmë edhe raportet e tjera për mostrat e dërguara për identifikim përmes analizës së ADN-së, me shpresën që edhe familjet e tjera të marrin përgjigjet që presin prej 27 vitesh. Asnjë përgjigje nuk mund ta shuajë dhimbjen e humbjes, por njohja e së vërtetës i jep fund ankthit të pritjes për të mësuar fatin e më të dashurve.

Më 27 korrik u konfirmua gjetja e varrit masiv në Kalludër. Gjatë vizitës në këtë lokacion, theksova se është letike që faktorët ndërkombëtarë, me në krye Shtetet e Bashkuara të

LAJMI I FUNDIT

14:37 Shpërndanin lëndë narkotike të ndara në doza në qytetin e Laçit, arrestohen dy persona

14:18 U dënuan nga Gjykata e Hagës, Veliaj propozon shpalljen “Qytetarë Nderi” për katër ish-krerët e UÇK-së

14:00 Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së, Berisha: Asgjë nuk e nxin luftën çlirimtare të Kosovës

13:55 Dy dronë të paidentifikuar SHPËRNDARËSHkelin hapësirën ajrore të ARTIKULLINMoldavisë, alarm në Kishinau

13:43 I akuzuar për spiunazh në favor të Izraelit, Irani ekzekuton një tjetër të dënuar

13:30 Sulmet ruse vrasin 11 persona dhe plagosin dhjetëra të tjerë gjatë 24 orëve të fundit në Ukrainë

TESTIM

Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar dhe Bashkimi Evropian, të shtojnë tryshninë ndaj Serbisë për zbatimin e Deklaratës për Personat e Zhdukur, të dakorduar më 2 maj 2023 në Bruksel, veçanërisht për hapjen e menjëhershme të arkivave, përfshirë arkivin e Brigadës së 37-të të Motorizuar të Ushtrisë Jugosllave, e cila ka kryer masakra në Kosovë, posaçërisht në Drenicë, dhe dokumentacionin e së cilës Serbia ka klasifikuar në vitin 2014 për një periudhë prej tridhjetë vjetësh.

Përkushtimi ynë institucional do të vazhdojë me kërkime në terren, mbështetje për procesin e identifikimit dhe komunikim të drejtpërdrejtë e të kujdesshëm me familjet. Do të qëndrojmë pranë tyre dhe do t'i mbështesim në kërkesat për të vërtetën, drejtësinë dhe kthimin me dinjitet të më të dashurve.

Zbardhja e fatit të çdo personi të zhdukur me dhunë është prioritet shtetëror i Republikës së Kosovës dhe detyrim njerëzor, që mbetet i hapur për sa kohë qoftë edhe një familje pret përgjigje.

Edhe gjatë vizitës në Shtetet e Bashkuara dhe në takimet në kuadër të sesionit të 81-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ashtu si çdo ditë në punën time dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës e vërteta për fatin e më të dashurve tanë dhe drejtësia për viktimat e familjet e tyre do të jenë në qendër të angazhimit tonë. Pjesë e pandashme e kësaj agjende do të jetë kërkesa që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian dhe Mbretëria e Bashkuar të shtojnë tryshninë ndaj Serbisë për zbatimin e zotimeve të marra, hapjen e arkivave dhe ofrimin e informacionit që mundëson zbardhjen e fatit të personave të zhdukur me dhunë.

Shiko në:

| LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | RAJONI

U dënuan nga Gjykata e Hagës, Veliaj propozon shpalljen “Qytetarë Nderi” për katër ish-krerët e UÇK-së

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ka reaguar këtë të shtunë nga qelia për sa i përket vendimit të Gjykatës së Hagës ndaj ish-krerëve...

14:18 | 19/09/2026

KOSOVË | RAJONI

Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së, Berisha: Asgjë nuk e nxin luftën çlirimtare të Kosovës

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, gjatë një komunikim në rrjetin social këtë të shtunë me qytetarë, ka folur sërish për vendimi e Gjykatës së...

14:00 | 19/09/2026

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT | RAJONI | REVIEW

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Vokshi tregon prapaskenat: Lidhet me konfliktin e Thaçit me Gjermaninë

I ftuar në “Review” me Greta Topjanën, analisti Indrit Vokshi solli një tjetër interpretim mbi atë që, sipas tij, fshihet pas dënimit të ish-krerëve të...

22:32 | 18/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.